



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 4448 Prot.

Tiranë, më 28.5. 2018

Nr. Identifikimi 386

Vendimi 23

### DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

#### VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Emri i Subjektit:** "ALESIO - 2014" sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** L41713003M

**Adresa e selisë:** Njësia Bashkiake Nr. 11, Rruga "Lord Bajron", Banesë private Nr. 14, Tiranë

**Personi përgjegjës** Anton Gjinaj

Për të zhvilluar projektin: "**Shfrytëzim gipsi**"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Zona Minerare konkurruese Nr. 295, objekti "Mengaj", Qarku Tiranë

**Sipërfaqja totale:** 0.049 km<sup>2</sup>

**Lloji Mineralit:** Gips

**Kapacitetit i parashikuar:** 10 000 ton/vit

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*



Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

#### ***Drejtoria Teknike të Ministrisë shprehen:***

- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat dhe një relacion për mënyrën e shfrytëzimit dhe sipërfaqen e vërtetë të fondit pyjor/kullozor publik që preket.
- Nuk janë mbajtur parasysh përcaktimet e VKM-së nr. 247, datë 30.04.2015 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".
- Sugjerojmë të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- Subjekti t'i vendoset kusht që t'i përmbahet kërkesave të ligjit nr. 10266 datë 15.04.2010 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i cili amendon ligjin nr. 8897 datë 16.05.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" dhe VKM-së nr.435 datë 12.09.2015 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, subjekti duhet të hartojë një plan masash paraprake për të ulur shkarkimet në ajër.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

***Drejtoria Rajonale e Mjedisit Qarku Tiranë, shprehet:*** parimisht dakort për zhvillimin e aktivitetit.

***Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:*** Subjekti "ALESIO 2014", kërkon të zhvillojë aktivitetin "Projekt për shfrytëzimin e gipsit", me vendodhje në fshatin Mëngaj, bashkia Kavajë, qarku Tiranë. Pas shqyrtimit të Raportit Paraprak të VNM-së dhe pozicionit topografik në hartën e shkallës 1:25000, rezulton se sipërfaqja e kërkuar për zhvillimin e këtij aktiviteti, është jashtë sistemit të zonave të mbrojtura, por në afërsi të kësaj sipërfaqeje ndodhet Monumenti i Natyrës "Shpella Karstike në Gips", shpallur me VKM-në Nr. 676, datë 20.12.2002, "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare", kategoria III e zonave të mbrojtura. (sipas hartës së paraqitur, sipërfaqja e paraqitur, shtrihet në veriperëndim, të MN-së, në një distancë afërsisht 250 m. Bazuar nga sa më sipër cituam, mendojmë se punimet në karrierë nuk duhet të zhvillohet në drejtim të monumentit të natyrës, subjekti duhet të respektojë distancën prej 200 m nga perimetri i monumentit të natyrës (zona buferike), e parashikuar në Ligjin nr.81, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura".

### **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

***Konsultimi me publikun:*** Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë



kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

### **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Njoftimin Fitues Nr. Prot. 5236/4 datë 07.09.2017 për zonën minerare konkurruese Nr. 295, për objektin objekti “Mengaj”, Qarku Tiranë, lloji i mineralit gips, veprimtaria shfrytëzim, e miratuar në planin vjetor minerare të vitit 2011.
4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:
    - 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
    - 4.2 Aktiviteti të respektojë distancën prej 200 m nga perimetri i monumentit të natyrës (zona buferike), e parashikuar në Ligjin nr.81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”.
    - 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
    - 4.4 Kjo deklaratë është e vlefshme pas miratimit nga MIE për Lejen e Shfrytëzimit.
    - 4.5 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.

#### **Gjatë fazës së instalimit:**

- 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore
- 4.7 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.8 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.9 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.10 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.11 Të sistemohen brenda sipërfaqjes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.12 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.13 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.14 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".



- 4.15 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.16 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.17 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.18 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.19 Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, “Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar, Shtojca I, duhet t’i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**

**MINISTRI**

**BLENDI KLOSI**





**Aneksi 1. Harta me koordinatat**

MINISTRIA E ENERJISË DHE INDUSTRIË  
DREKTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË MINIERAVE  
TIRANË

**Harta topografike në shkallë 1:25000 e zonës minerare Nr. 295**

**Leja Minerare Nr... (zona 295)**



 <b>MINISTRIA E ENERJISË DHE INDUSTRIË</b> <b>DREKTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË MINIERAVE</b> <b>OBJEKTI "Mongol", Qarku i Tiranës</b>		<b>Kordinatat</b>		
		Pika	X	Y
Leja nr.	L... (zona 295)	1	4564245	4385500
Shtetësi	Gips	2	4564270	4385580
Lloji i lejes	Shtyrtëzim	3	4564110	4385710
Sipërfaqja, km <sup>2</sup>	0.049	4	4563930	4385747
Neritan Aleksi	data firma	5	4563887	4385626

SECRETARIA